REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Maliq më 19.12.2024

PROJEKT-VENDIM
Nr. 4 Datë 19/12/2024

PËR NIVELIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, ADMINISTRIMIN E TYRE NË BASHKINË MALIQ, PENALITETET PËR SHKELJET APO KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025

Mbështetur ligjin nr. 139/2015 "*Per vetqeverisjen vendore*", të nenit 54, në gërmën "f", në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, në V.K.M nr 132, datë 07.03.2018 "*Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe regullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës*", në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 " *Për financat e vetqeverisjes vendore*", në ligjin nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", ligjin 152/2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*", ligjin 8519 datë 30.07.1999 "*Për ujitjen dhe kullimin*", i ndryshuar, ligjin 9385 datë 04.05.2005 "*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*", i ndryshuar,ligjin 10465, datë 29.09.2011 "*Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë*", ligjin 10279 datë 20.05.2010 "*Për kundravajtjet administrative*", pas diskutimeve në mbledhje.Këshilli vendosi:

I. Të miratojë nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë e Maliq si dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2025 sipas materialit dhe pasqyrave bashkëngjitur.

II. Të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak që bien në kundërshtim me këtë akt, shfuqizohen.

III.Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e të Ardhurave dhe të gjitha strukturat e tjera që kanë lidhje me këtë vendim .

IV. Ky vendim hyn ne fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", indryshuar

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI I BASHKISË

PAKETA FISKALE
2025

Dhjetor , 2024

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

Përmbajtja

A-TAKSA VENDORE 3
1.b) Taksa mbi tokën bujqësore. 6
1.c) Taksa mbi truallin. 6
2. TAKSA E FJETJES NË HOTEL 7
3 .TAKSA MBI RENTËN MINERARE 8
4.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA. 8
5. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME 9
6. TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA. 9
7.TAKSA E TABELËS. 10
8.TAKSA E PËRKOHËSHME PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE (Telefoni, Energji, TV kabllor, Internet) 12
9. DHËNIE E LIÇENCAVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËN PRODUKTEVE TË SAJ 12
B- TARIFAT VENDORE 13
1. TARIFË PASTRIMI 13
2. TARIFË GJELBËRIMI 14
3. TARIFË NDRIÇIMI 14
4. NIVELET E TARIFËS PËR SHËRBIMIN NË FUSHËN E TRANSPORTIT 16
5.TARIFË PARKIMI 18
6.TARIFË PËR MIRËMBAJTJEN E VARREZAVE PUBLIKE 18
7.TARIFË ADMINISTRATIVE 18
9.TARIFA TË NDRYSHME NË BASHKI 19
10.TARIFA TË NDRYSHME PËR SHËRBIMET NË BASHKI 20
C- LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE QË DO TË VENDOSEN NGA INSPEKTORËT E DREJTORISË SË KONTROLL TERRITORIT DHE DREJTORISË SË TË ARDHURAVE NË RASTET E SHKELJEVE DHE KUNDËRVAJTJEVE ADMINISTRATIVE: 32

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

PAKETA FISKALE 2025

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*", të nenit 54, në gërmën "l", në ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar, në V.K.M nr 132, datë 07.03.2018 "*Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe regullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës*", në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar, në ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, në ligjin nr. 68/2017 " *Për financat e vetqeverisjes vendore*", në ligjin nr. 107/2014 "*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*", ligjin 152/2015 "*Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin*", ligjin 8519 datë 30.07.1999 "*Për ujitjen dhe kullimin*", i ndryshuar, ligjin 9385 datë 04.05.2005 "*Për pyjet dhe shërbimin pyjor*", i ndryshuar, ligjin 10465, datë 29.09.2011 "*Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë*", ligjin 10279 datë 20.05.2010 "*Për kundravajtjet administrative*", i propozoj, Këshillit të Bashkisë:

A-TAKSA VENDORE

1. TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME.

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive, Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

a) taksa mbi ndërtesat
b) taksa mbi tokën bujqësore
c) taksa mbi truallin

1.a) Taksa mbi ndërtesat

Llogaritja e taksës së ndërtesës është bërë në mbështetje të V.K.M nr 132, datë 07.03.2018 " Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", baza e taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" nenit 2 pika 3 ku thuhet:

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale/nënzonale të territorit, brenda juridiksionit të tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) përqind ose minus 30 (tridhjetë) përqind. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në Njësitë Administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 115/2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1, deri në masën minus 35 (tridhjetë e pesë) përqind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. **Taksa mbi Pasurinë propozohet të miratohet pa ndryshim si në vitin 2024.**

Tabela 1 :Shkalla e taksës

Njësia Administrative/Zona fiskale	Shkalla e taksës për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret/shfrytëzohet për:					
	Banim			Veprimtari ekonomike		
	Shkalla e taksës sipas VKM 132	Ndryshimi i shkallës së taksës i miratuar	Shkalla e taksës e miratuar	Shkalla e taksës sipas VKM 132	Ndryshimi i shkallës së taksës i miratuar	Shkalla e taksës e miratuar
Maliq	0.05%	-30%	0.035%	0.20%	-30%	0.26%
Libonik	0.05%	-30%	0.035%	0.20%	-30%	0.26%
Gorë	0.05%	-30%	0.035%	0.20%	-30%	0.26%
Moglicë	0.05%	-30%	0.035%	0.20%	-30%	0.26%
Vreshtas	0.05%	-30%	0.035%	0.20%	-30%	0.26%
Pirg	0.05%	-30%	0.035%	0.20%	-30%	0.26%
Pojan	0.05%	-30%	0.035%	0.20%	-30%	0.26%

Tabela 2: Ndryshimet e miratuara të çmimeve mesatare referuese

Njësia Administrative	Çmimi mesatar referues sipas VKM 132 (Lekë)	Çmimi i miratuar (Lekë)
Libonik	27,800	27,800
Gorë	27,800	27,800
Moglicë	27,800	27,800
Vreshtas	27,800	27,800
Pirg	27,800	27,800
Pojan	27,800	27,800

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

Njësitë Administrative Përbërëse	Çmimi referues i miratuar	Shkalla e taksës e miratuar		Vlera për metër katror për banesat që përdoren/shfrytëzohen për banim			Vlera për metër katror për banesat që përdoren/shfrytëzohen për veprimtari ekonomike				
		Familje	Biznes	Shtëpi/ Apartament (1)	Parkim i mbuluar ose Bodrum (0.7)	Banesa të privatizuara ne 1993, vetëm pë shitjen e parë (0.7)	Njësi tregëtimi dhe Shërbimi (1.5)	Parkim i mbuluar ose Bodrum (0.7)	Parkim i hapur (0.3)	Njësi industriale prodhimi, magazinimi (0.5)	Njësi që përdoren për bujqësi ose blektori (0.3)
Maliq	27,800	0.035%	0.26%	9.73	6.81	6.81	108.42	50.60	21.68	36.14	21.68
Libonik	27,800	0.035%	0.26%	9.73	6.81	6.81	108.42	50.60	21.68	36.14	21.68
Gorë	27,800	0.035%	0.26%	9.73	6.81	6.81	108.42	50.60	21.68	36.14	21.68
Moglicë	27,800	0.035%	0.26%	9.73	6.81	6.81	108.42	50.60	21.68	36.14	21.68
Vreshtas	27,800	0.035%	0.26%	9.73	6.81	6.81	108.42	50.60	21.68	36.14	21.68
Pirg	27,800	0.035%	0.26%	9.73	6.81	6.81	108.42	50.60	21.68	36.14	21.68
Pojan	27,800	0.035%	0.26%	9.73	6.81	6.81	108.42	50.60	21.68	36.14	21.68

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
d) banesat sociale në pronësi të bashkive;
e) pasuritë e paluajtshme - ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
f) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
g) strukturat akomoduese " *Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special* ", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht " *brand name* ";
h) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/ pension social/ kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
i) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
j) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

Afatet e pagesës

1. Detyrimi vjetor për kategorinë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim të shpërndahen në periudhën **Janar – Mars 2025**, dhe detyrimi vjetor për taksën mbi ndërtesës do të paguhet pranë sporteleve të Bashkisë Maliq ose pranë Njësive Administrative. Detyrimi vjetor do të paguhet brenda datës **30.09.2025.**
2. Detyrimi vjetor për kategorinë ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike do të paguhet brenda datës **30.06.2025 .**

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me **0,06** për qind të shumës

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

së detyrimit të papaguar për çdo ditë. gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

-Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për biznesin është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Maliq.

-Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesën për familjarët është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Maliq, kurse për njësitë e tjera administrative struktura e ngarkuar është Njësia Administrative.

1.b) Taksa mbi tokën bujqësore.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit, është detyrim vjetor dhe paguhet brenda datës 30.09.2025. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore. Pas vetëdeklarimit Drejtoria e të Ardhurave mund të bëjë verifikimin sipas vlerësimit të rastit në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përllogaritet për të gjithë periudhën.

Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori janë si vijon:

Klasifikimi sipas kategorisë së tokës bujqësore	Vlera e taksës në lekë/hektar/vit sipas Ligjit	Vlera e taksës së propozuar - 20% lekë/hektar/vit
I	4 200	**3,360**
II	3 500	**2,800**
III	2 800	**2,240**
IV	2 300	**1,840**
V	1 900	**1,520**
VI	1 600	**1,280**
VII-X	1 400	**1,120**

Përjashtime

Përjashtohen nga taksa mbi tokën bujqësore, tokat bujqësore që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për **5 vitet** e para nga çasti i mbjelljes. Drejtoria e Bujqësisë në Bashki të përcaktojë mbjelljet e çdo viti kalendarik. Për çdo fermer që rezulton se ka mbjellë kultura drufrutore ose vreshtari në 5 vitet e fundit pajiset me një dokument të lëshuar nga agronomi i Njesise Administrative dhe Administratori respektiv.

Agronomi i njesise ndjek dhe rakordon me zyrtën e tatim – taksave në njësi sipërfaqen dhe shlyerjen e detyrimit për çdo fermer.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Maliq si dhe Njësitë Administrative.

1.c) Taksa mbi truallin.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit dhe është detyrim vjetor i taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim. Pas vetëdeklarimit Drejtoria e të Ardhurave mund të bëjë verifikimin sipas vlerësimit të rastit në lidhje me saktësinë e këtij deklarimi dhe në raste të konstatimit të deklarimit të ndryshëm me realitetin pagesa do përllogaritet për të gjithë periudhën.
Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme.

Kategoritë minimale të bazës së taksës dhe nivelet treguese të taksës për çdo kategori minimale të bazës për taksën mbi truallin është si vijon:

Bashkia	**Vlera e taksës lekë/ m²/vit për qëllime banimi nga individët**	**Vlera e taksës lekë/ m²/vit për qëllime biznesi**
Bashkia Maliq	**0,14 lekë/m²**	**12 lekë/ m²**

Afatet e pagesës

- Detyrimi vjetor për kategorinë truall për qëllime banimi nga individët do të shpërndahet në periudhën Janar – Mars 2025 dhe detyrimi vjetor për taksën mbi truallin do të paguhet pranë sporteleve të Bashkisë Maliq dhe Njësive Administrative brenda **datë 30.09.2025**.
- Detyrimi vjetor për kategorinë truall për qëllime biznesi do të paguhet brenda datës **30.06.2025**.
- Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me **0,06 për qind** të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për biznesin është Drejtoria e të Ardhurave pranë Bashkisë Maliq/ Njësitë Administrative.

2. TAKSA E FJETJES NË HOTEL.

Me **"hotel"** kuptohet çdo veprimtari, që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim. Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel, për person. Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga Bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel".

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

Kategoritë minimale të taksës së fjetjes në hotel	Bashkia Maliq
Hotelet 4-5 yje	105 lekë/natë fjetje
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	35 lekë/natë fjetje

Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë, bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0.06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq.

3 .TAKSA MBI RENTËN MINERARE

Në bazë të ligjit nr. 9975 datë 28.07.2008 "*Për taksat kombëtare*" i ndryshuar, neni 4 pika 4 : Renta minerare llogaritet në përqindje të vlerës së siguruar nga shitja e mineralit të papërpunuar, të prodhuar nga zona e lejuar minerare, dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit dhe në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore përkatëse.

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare, 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.

Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore. Pagesa e rentës minerare bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës, kur janë realizuar shitjet. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit.

4.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA.

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Niveli i taksës në % sipas ligjit	Propozohet në %
Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit	4-8	4

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

të një kontrate koncensionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.		
Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, bujqësisë; si dhe të ndërtimeve për qëllime publike.	1-3	2
Të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara vetë individi apo me sipërmarrës;	1-3	1
Për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte	0.1	0.1
Ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	0.5	0.5
Për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore.	0-3	0.5

Struktura e ngarkuar për përllogaritjen, vjeljen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Maliq.

5. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me legjislacionin. Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.

-Niveli i taksës caktohet në **lekë/m²** katror të bazës së taksës.
-Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.
-Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre
-Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është **2 për qind.**
-Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij sipas tabelës që vijon :

Kategoritë e ndërtesave	Bashkia Maliq/ Njësitë Administrative lekë/m²
I. Ndërtesa banimi	100
II. Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	300
III. Ndërtesa të tjera	200

Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është **Agjencia Shtetërore e Kadastrës,** e cila në rolin e agjentit tatimor, përfiton 3 për qind të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdhin për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

6. TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

Drejtoritë Rajonale të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DRSHTRR), të cilat janë agjent tatimor të mbledhjes së taksës vjetore të mjeteve të përdorura bazuar në legjislacionin në fuqi, mbledhin këtë taksë dhe e derdhin, brenda datës 30 të çdo muaji, për llogari të organeve tatimore të administratës qëndrore dhe njësive të qeverisjes vendore. Drejtoria rajonale e shërbimeve të transportit rrugor i ndan të ardhurat nga taksa e mjeteve të përdorura sipas njësive të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit që zotëron mjetin e transportit.

Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura, drejtoritë rajonale të DRSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5 % (*pesë*) të totalit mujor të të ardhurave, derdhin me anë të faturës për arkëtim, 25 % (*njëzetepesë*) të këtyre të ardhurave në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore, dhe 75 % (*shtatëdhjeteepesë*) të të ardhurave, DPSHTRR-ja e derdh për llogari të drejtorisë rajonale, ku është regjistruar (drejtoria rajonale e tatimpaguesve të mëdhenj).

Rakordimi i pagesës së taksës ndërmjet strukturave të DRSHTRR-së me organet tatimore të administratës qëndrore dhe vendore kryhet në bazë të regjistrit ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, formati i të cilit është i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave.
Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7.TAKSA E TABELËS.

Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizike, juridike, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Maliq.
Tabelat ndahen në:
I) Tabelë për qëllime identifikimi, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për te reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit);
II) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formen dhe përmasat e tabelave për orientim;
III) Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme ose e palëvizshme;
IV) Tabelë për funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Niveli i kësaj takse për Bashkinë Maliq është si më poshtë vijon:

I.	**Taksë tabele për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)**		
a	**deri në 2 m²**	lekë/m²/vit	0
b	**mbi 2 m² deri në 10 m²**		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m²/vit	7 000
	me ndiçim të thjeshtë	lekë/m²/vit	11 500
	elektronike	lekë/m²/vit	15 000
c	**mbi 10 m² deri 20 m²**		

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m²/vit	5 950
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m²/vit	9 775
	elektronike	lekë/m²/vit	12 750
ç	**mbi 20 m² deri 40 m²**		
	e thjeshtë(pa ndriçim)	lekë/m²/vit	3 850
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m²/vit	6 325
	elektronike	lekë/m²/vit	8 250
d	**mbi 40 m²**		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m²/vit	2 800
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m²/vit	4 600
	elektronike	lekë/m²/vit	6 000
II.	**Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim**		
	Tabela identifikuese	lekë/m²/vit	120
III.	**Tabela për qëllime reklamimi e lëvizëshme e palëvizëshme deri në tavanin maksimal 35 m²**		
	E thjeshtë (me/ pa ndriçim)	lekë/m²/vit	13 500
	Elektronike	lekë/m²/vit	27 000
IV.	**Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda, reklamuese, banderol, etj.**		
	Të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m²/vit	1000

Detyrimi i kësaj takse është vjetor dhe pagesa bëhet paralelisht me pagesën e taksave dhe tarifave të tjera. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj. për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejës së dhënë.

Afati i pagesës:

-Brenda datës **30.06.2025** për subjektet e regjistruara ;

-Për subjektet që regjistrohen pas datës 30.06.2025 **brenda 30 ditëve** nga momenti i regjistrimit.

-Gjithashtu të gjithë subjektet e tjera të cilat do të vendosin një tabelë gjatë vitit 2025 afati i pagesës është 30 ditë nga data e identifikimit.Taksapaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me **0,06 për qind** të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

- Struktura e ngarkuar për miratim për të vendosur tabelë identifikuese / reklamuese është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Maliq bazuar kjo në kërkesën e vetë subjektit që do të vendosë tabelë identifikuese/reklamuese.
- Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

- Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos miratim për vendosje tabele reklamuese është Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

8.TAKSA E PËRKOHËSHME PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE (Telefoni, Energji, TV kabllor, Internet)

Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit sipas Njësisë Administrative ku ai ushtron aktivitet.
Niveli i taksës së përkohëshme për linjat ajrore dhe nëntokësore paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kategoritë	Njësitë Administrative	Vlera(Lek/vit)
1.	Linja ajrore dhe linja nentokesore (sitemi kabllor, trasmetimet televizive, telefon dhe internet)	Maliq, Libonik, Pojan, Pirg	100 000
		Vreshtas	100 000
		Gorë, Moglicë	50 000

9. DHËNIE E LIÇENCAVE PËR TREGËTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËN PRODUKTEVE TË SAJ

Bazuar në Ligjin Nr.8450, datë 24.2.1999 "*Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre*" të ndryshuar me Ligjin Nr .9218, datë 08.04.2004 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre*", si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 129, datë 18.03.1999 "*Për proçedurat dhe kushtet për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregëtimin e naftës, të gazit e të nënprodukteve të tyre*" i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 për "*Përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës bruto dhe nën produkteve të saj*" Bashkia Maliq jep licence për personat juridikë të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre për tregëtimin e karburanteve për automjete (stacionet e shitjes së karburanteve) dhe për shitjen e lëndëve djegëse (njësitë e shitjes së lëndëve djegëse) në territorin e Bashkisë Maliq.
Licencat jepen nga Bashkia Maliq **për një periudhë deri në 5 (pesë) vjet** me të drejtë përsëritjeje dhe pagesa për dhënie autorizimi për dy kategoritë e mësipërme është si më poshtë vijon:

- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjete dhe vajra lubrifikante.

1,000,000 lekë

- Pagesë për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregëtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë.

100,000 lekë

- Për dublikatë për të njëjtin stacion dhe afat vlefshmërie apo rastet e ndryshimeve në licencë që kanë të bëjnë me elementet e përdoruesit të stacionit paguhet 20% e vlerës së plotë.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

Struktura e ngarkuar për dhënien e kësaj licence dhe vjeljen e detyrimit është Drejtoria e të Ardhurave në Bashkinë Maliq.

B- TARIFAT VENDORE

Tarifat vendore aplikohen për çdo familje rezidente në Bashkinë Maliq, çdo biznes që ushtron veprimtarinë ekonomike brenda territorit të Bashkisë Maliq si dhe për çdo person fizik ose juridik të huaj që ushtron veprimtari në territorin e Bashkisë.

lekë/vit

I	**TARIFË PASTRIMI**		
Nr.	**KATEGORITË**	**ZONA A (*Nj.Ad Maliq, Pojan, Libonik, Pirg, Vreshtas*)** *lekë/vit*	**ZONA B (*Nj.Ad Gorë, Moglicë*)** *lekë/vit*
I	**FAMILJARËT**	1.800	900
II	**BIZNESI**		
II.1	**Biznes i Vogel**		
a	Biznes i vogël me qarkullim vjetor 0-2 milion lekë në vit	8.000	4.000
b	Biznesi i vogël me qarkullim vjetor 2-3 milion lekë në vit	9.000	6.000
c	Biznesi i vogël me qarkullim vjetor 3-5 milion lekë në vit	10.000	8.000
ç	Biznesi i vogël me qarkullim vjetor 5-8 milion lekë në vit	15.000	10.000
II.2	**Biznes i madh**		
a	Për çdo njësi tregëtimi, shërbimi	50.000	40.000
b	Për çdo njësi prodhimi	50.000	40.000
c	Subjektet e ndertimit, Hidrocentrale, Gurore,	120.000	
ç	Subjekte të përpunimit të peshkut dhe nënprodukte të tyre	200.000	
d	Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to) a) 0- 5.000.000 lekë/investim b) 5.000.001- 15.000.000 lekë/investim c) Mbi 15.000.000 lekë/ inestim Ndërtim objekte banimi individuale Ndërtim objekte bujqësore/indstriale Rikonstruksione objekte bujqësore/indstriale Rikonstruksione të banesave individuale Ndërtim objekte të kombinuara	 50.000 lekë/ kantier 75.000 lekë/kantier 100.000 lekë/kantier 15.000 lekë/kantier 40.000 lekë/kantier 20.000 lekë/kantier 8.000 lekë/kantier 25.000 lekë/kantier	
dh	Shoqata, Fondacione, OJF	15.000	
e	Institucionet shteterore (Banka, OSHEE, Qendra Shëndetësore, Posta Shqipëtare, Sigurime shoqërore)	50.000	
ë	Karburante, Magazine frigoriferike	50.000	

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

II.6	**Për tregëtarët Ambulant**	2.500	
II.7	**Transporti brenda vendit**		
a	Transport udhëtarësh (1+4), (1+6) dhe (1+8)	5.000	3.000
b	Transport udhëtarësh për autobus	9.000	7.000
c	Transport malli deri në 3,5 ton	6.000	4.000
ç	Transport malli mbi 3,5 ton	8.000	6.000

2	**TARIFË GJELBËRIMI**		
Nr.	KATEGORITË	ZONA A (*Nj.Ad Maliq, Pojan, Libonik, Pirg, Vreshtas*) ***lekë/vit***	ZONA B (*Nj.Ad Gorë, Moglicë*) ***lekë/vit***
I	**FAMILJARËT**	100	0
II	**BIZNESI**		
II.1	**Biznes i Vogel**		
a	Biznes i vogël me qarkullim vjetor 0-2 milion lekë në vit	1.000	500
b	Biznesi i vogël me qarkullim vjetor 2-3 milion lekë në vit	1.200	600
c	Biznesi i vogël me qarkullim vjetor 3-5 milion lekë në vit	1.500	800
ç	Biznesi i vogël me qarkullim vjetor 5-8 milion lekë në vit	2.000	1.000
II.2	**Biznes i madh**		
a	Për çdo njësi tregëtimi dhe shërbimi	5.000	5.000
b	Për çdo njësi prodhimi	5.000	5.000
c	Subjektet e ndërtimit,Hidrocentrale, gurore,	20.000	
ç	Subjekte të perpunimit të peshkut dhe nënprodukteve të tyre	10.000	
d	Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to) Ndërtim objekte banimi individuale Ndërtim objekte bujqësore/indstriale Rikonstruksione objekte bujqësore/indstriale Rikonstruksione të banesave individuale Ndërtim objekte të kombinuara	5.000 lekë/ kantier 2.000 lekë/kantier 5.000 lekë/ kantier 2.000 lekë/kantier 1.000 lekë/kantier 3.000 lekë/kantier	
dh	Shoqata, Fondacione, OJF	2.000	
e	Institucionet shteterore (Banka, OSHEE, Qendra Shëndetësore, Posta Shqipëtare, Sigurime shoqërore,)	2.000	
ë	Karburante, magazine frigoriferike	5.000	
II.3	**Për tregëtarët Ambulant**	500	

3	**TARIFË NDRIÇIMI**		
Nr.	KATEGORITË	ZONA A	ZONA B

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

		(*Nj.Ad Maliq, Pojan, Libonik, Pirg, Vreshtas*)	(*Nj.Ad Gorë, Moglicë*)
I	**FAMILJARËT** lekë/vit	800	250
II	**BIZNESI**		
II.1	**Biznes i Vogel**		
a	Biznes i vogël me qarkullim vjetor 0-2 milion lekë/vit	1.800	500
b	Biznesi i vogël me qarkullim vjetor 2-3 milion lekë/vit	1.800	500
c	Biznesi i vogël me qarkullim vjetor 3-5 milion lekë/vit	2.000	1.000
ç	Biznesi i vogël me qarkullim vjetor 5-8 milion lekë/vit	2.000	1.000
II.2	**Biznes i madh**		
a	Për çdo njësi tregëtimi dhe shërbimi lekë/vit	6.000	4.000
b	Për çdo njësi prodhimi lekë/vit	6.000	4.000
c	Subjektet e ndertimit,Hidrocentrale, gurore, lekë/vit	20.000	
ç	Subjekte të perpunimit të peshkut dhe nënp. të tyre lekë/vit	10.000	
d	Njësi ndërtimi (për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi kolektive e tregëtare, zyra dhe të tjera të ngjashme me to) Ndërtim objekte banimi individuale Ndërtim objekte bujqësore/indstriale Rikonstruksione objekte bujqësore/indstriale Rikonstruksione të banesave individuale Ndërtim objekte të kombinuara	5.000 lekë/ kantier 2.000 lekë/kantier 5.000 lekë/ kantier 2.000 lekë/kantier 1.000 lekë/kantier 3.000 lekë/kantier	
dh	Shoqata, Fondacione, OJF lekë/vit	2.000	
e	Institucionet shteterore (Banka, OSHEE, Qendra Shëndetësore, Posta Shqipëtare, Sigurime shoqërore,) lekë/vit	2.000	
ë	Karburante, magazine frigoriferike lekë/vit	6000	
II.3	**Për tregëtarët Ambulant** lekë/vit	200	

Përjashtime:

- Për bizneset e reja, të cilat administrohen nga gratë kryefamiljare, tarifat vendore reduktohen në masën 30% për vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit.
- Për bizneset e reja, të hapur rishtazi, të cilat admnistrohen nga të rrinj të moshës 18-25 vjeç, përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore për vitin 2025. (*Për subjekte të reja , me objekt të ndryshëm nga aktiviteti familjar primar.*)
- Familjet që trajtohen në ndihmë ekonomike apo qe perbehen vetëm nga "*pensioniste të vetmuar*" do të paguajnë vetëm 70 % të tarifave.
  - Në kategorinë "*pensionistë të vetmuar*" përfshihen të gjithë pensionistët e vetëm, pa përkrahje, që jetojnë në kushte të vështira ekonmike. Lista me të dhënat për këta persona do të sigurohet nga Sektori i Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Maliq.

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

- Gratë kryefamiljare që nuk janë në marrëdhënie pune përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore.
- Të përjashtohen nga tarifa e gjelbërimi familjet e fshatrave:
  - Në Njësinë Administrative Gorë të gjitha fshtarat.
  - Në Njësinë Administrative Moglicë të gjitha fshtarat.
  - Në Njësinë Administrative Libonik. fshatrat Zboq, Beras. Shkozë. Kembëthekër. Mëmël dhe Manastirec.
  - Njësinë Administrative Pirg fshatrat Bubuq dhe Qershizë.
- Të përjashtohen nga tarifa e pastrimit të gjithë banorët e fshatrave:
  - Në Njësinë Administrative Gorë të gjithë banorët e fshatrave përveç : Zvarisht, Lozhan i ri dhe Lozhan.
  - Në Njësinë Administrative Libonik. banorët e fshatrave Zboq. Beras. Shkozë. Kembëthekër. Mëmël dhe Manastirec.
  - Në Njësinë Administrative Maliq. banorët e fshatrave: Bickë. Goçë. Plovisht dhe Gjyras.
  - Në Njësinë Administrative Pirg, banorët e fshatrave: Bubuq dhe Qershizë.
  - Në Njësinë Administrative Moglicë të gjithë banorët e fshatrave përveç fshatit Moglicë.
- Të përjashtohen nga tarifa e ndriçimit:
  - Në Njësinë Administrative Maliq. banorët e fshatrave: Bickë. Goçë. Plovisht dhe Gjyras.
  - Në Njësinë Adminstrative Libonik. banorët e fshatrave: Shkozë. Këmbëthekër. Beras. Zboq, Memël dhe Manastirec.
  - Në Njësinë Adminstrative Gorë, banorët e fshtarave: Shalës. Selcë. Marjan, Dolanec, Mjaltas. Babjen.
  - Në Njësinë Admnistrative Moglicë përveç Moglicës. Zerecit dhe Popçisht të gjithe fshatrat e tjerë përjashtohen nga tarifa e ndriçimit.
  - Në Njësinë Administrative Pirg banorët e fshatit Bubuq dhe Qershizë.
- Të përjashtohen nga tarifa e mirëmbajtjes së kanaleve kullues:
  - Në Njësinë Administrative Maliq. banorët e fshatrave: Bickë. Goçë. Plovisht dhe Gjyras.
  - Në Njësinë Adminstrative Libonik. banorët e fshatrave: Shkozë. Këmbëthekër. Beras. Zboq. Memël dhe Manastirec.
  - Në Njësinë Administrative Pirg banorët e fshatit Bubuq dhe Qershizë.
  - Të gjithë banorët e Njësive Administrative Gorë dhe Moglicë.
- Të aplikohet ulje 10 % e tarifave vendore për të gjithë familjarët apo çdo subjekt debitor i cili i shlyen të gjitha detyrimet për taksat dhe tarifat vendore të prapambetura me një këst të vetëm.

3. NIVELET E TARIFËS PËR SHËRBIMIN NË FUSHËN E TRANSPORTIT

Këto tarifa arkëtohen përpara dhënies së licencës apo autorizimit nga Drejtoria e Tatim Taksave. Gjithashtu subjekti para kryerjes së kërkesës per Licensim duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet tatimore pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe të jetë pajisur me vërtetim nga

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

kjo drejtori. Në çdo rast kërkese nga ana e subjekteve. këta të fundit pajisen me liçencë apo Certifikatë nga Drejtoria ku përcaktohen të dhënat përkatëse

Niveli i tarifës per sherbimin ne fushen e trasportit: Kategoritë. nënkategoritë dhe nivelet treguese sipas llojshmerise se licensave e certefikatave janë të shprehura si më poshtë:

Nr.	Tarifat e licensimit	Njesia	Tarifa
I	**Tarifat e licensimit te trasportit te udhetareve**		
1	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	lekë/linje/10 vjet	80.000
2	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	lekë/mjet/vit	1.000
3	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	lekë/linje/10 vjet	40.000
4	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	lekë/mjet/vit	1.500
5	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	lekë/linje/5 vjet	75.000
6	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	lekë/mjet/vit	1.500
7	Liçencë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	lekë/linje/5 vjet	75.000
8	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	lekë/mjet/vit	1.500
9	Liçencë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	lekë/license/5 vjet	15.000
10	Liçencë për agjensi transporti ndërkombëtar udhëtarësh	lekë/license/5 vjet	40.000
11	Liçencë për transport udhëtarësh me taksi	lekë/license/5 vjet	20.000
12	Libri i udhëtimit për shërbimet e rastit të udhëtarëve brenda vendit (nr.fletëve/nr.udhëtimeve 10)	lekë/liber	5.000
13	Autorizim i përkohshëm një mujor	lekë/autorizim	2.000
II	**Tarifat e licensimit te trasportit te mallrave**	**Njesia**	**Tarifa**
1	Liçencë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	lekë/license/5 vjet	40.000
2	Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qira brenda vendit	lekë/ton/kapacitet	100x*
3	Çertifikatë për transport mallrash brenda vendit për llogari të vet	lekë/ton/kapacitet	100x*
4	Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshme Brenda vendit (për të tretë dhe me qira ose për llogari të vet)	lekë/ton/kapacitet	100x*
5	Çertifikatë për tërheqës	lekë/mjet/vit	1.500

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

6	Çertifikate per mjete teknologjike	lekë/mjet/vit	1.500
7	Vërtetim për ndryshim orari në linjat e miratuara	lekë/linjë	1.000

Shënime:

a) Për dublikatë me të njëjtën përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30% e vlerës së plotë.

b) Për rastet e ndryshimeve në licencë/çertefikatë që kanë të bëjnë me elementët e përdoruesit të mjetit,fushës së operimit etj. paguhet 30% e vlerës së plotë.

c) Për rastet kur subjektet figurojnë debitorë dhe kanë lidhur marrëveshje bashkëpunimi për pagesë me këste të detyrimeve,licencat dhe çertefikatat do të jepen me afat 1-vjeçar.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifes se licensimit është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Maliq si dhe Policia Bashkiake.

5.TARIFË PARKIMI

Tarifa e parkimit është detyrim i çdo individi/person fizik ose juridik i cili parkon në vendet e miratuara si "Parkim me pagesë"

Nr	Tarifa e parkimit	Njësia	Tarifa
1	Mjete transporti 1+4	Lekë/mjet/vit	4.000
2	Mjete transporti 1+6/1+8	Lekë/mjet/vit	6.000
3	Mjete transporti autobusa	Lekë/mjet/vit	7.000
4	Mjete transporti malli deri në 3.5 ton	Lekë/mjet/vit	3.000
5	Mjete transporti malli mbi 3.5 ton	Lekë/mjet/vit	6.000
6	Mjete transporti udhëtarësh nga Bashkitë e tjera	Lekë/orë/qëndrimi	50
7	Tarifë vjetore për parkim të rezervuar subjekte fizikë/ juridikë	Lekë/mjet/vit	15.000
8	Tarifë vjetore për parkim të rezervuar subjekte me TVSH jo rezident	Lekë/mjet/vit	30.000

6 .TARIFË PËR MIRËMBAJTJEN E VARREZAVE PUBLIKE

	➢ çdo familje në njësinë administrative Maliq ➢ çdo familje në njësitë administrative të tjera	300 lekë në vit

7 .TARIFË ADMINISTRATIVE

	Për çdo biznes që ushtron aktivitetin në territorin e Bashkisë	200 lekë në vit

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

8. TARIFË PËR NDIKIMIN NË MJEDIS

	Kategoria e subjekteve	Vlera
1	Subjektet, persona juridikë që ushtrojnë aktivitet të tillë si: karrierë guri (gurore), shfrytëzim të argjilave, subjekte ndërtimi, biznes i madh për përpunimin e drurit.	50.000 lekë/vit
2	Subjektet e ndërtimit për zbatimin e projekteve.	20.000 lekë/vit
3	KRWM	300.000 lekë/vit
4	Subjektet juridike (Biznes i madh/ VIP) që ushtrojnë aktivitet të tillë si industria e peshkut dhe nënprodukteve, grumbullimi dhe asgjesimi i mbetjeve metalike apo aktivitete të tjera që ndikojnë ne mjedis	250.000 lekë/vit

9.TARIFA TË NDRYSHME NË BASHKI

I	Tarifë për zënien e hapësirës publike	Njësia	Tarifa
1	Për qytetin e Maliqit	Lekë/m²/ muaj	60
2	Për njësitë administrative	Lekë/m²/ muaj	30
3	Për ekspozim malli jashtë dyqanit në Maliq	Lekë/m²/ muaj	60
4	Për ekspozim malli jashtë dyqanit në njësitë administrative	Lekë/m²/ muaj	30
5	Për organizim panaire,tregëtim në hapësira publike	Lekë/m²/ ditë	30

Ngarkohet Drejtoria e Pronave për ndjekjen, matjen dhe kontrollin e territorit, për sipërfaqet të cilat shfrytëzohen nga bizneset si dhe me përgatitjen e Lejes së Shfrytëzimit të Hapësirës Publike.

Ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave për faturimin e hapësirës publike pas miratimit të Lejes përkatëse.

Struktura e ngarkur me penalitetet për mospaisje dhe moszbatim të këtyre lejeve është **Policia Bashkiake.**

Nr	Tarifa	Njësia	Tarifa
II	**Tarifë për të drejtën e përdorimit të pronës publike vendore**	**Njësia**	**Tarifa**
1	Tarifa e tregut të lirë	Lekë/m²/ ditë	30
2	Dhënie me qera të objekteve për qëllime banimi	Lekë/m²/muaj	10
3	Dhënie me qera e stadiumit	Lekë/ndeshje	10.000
4	Dhënie me qera e sallës së Këshillit bashkiak	Lekë/orë	10.000
5	Tarifë për zenien e hapesirave publike nga ATM	Lekë/muaj	5.000
III	**Tarifë për aktivitetet kulturore dhe sportive**	**Njësia**	**Tarifa**
1	Biletë për shfaqje premierë	Lekë/shfaqje	100
2	Biletë për hyrje ne pylli i fazaneve për fëmijë nën 12 vjeç	Lekë/person	Falas
3	Biletë për hyrje ne pylli i fazaneve për të rritur	Lekë/person	50
4	Biletë për hyrje ne pylli i fazaneve për grupe shkollash	Lekë/person	20

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al

5	Biletë Sporti	Lekë/person	100
6	Marrje me qira biçikleta te Pylli i Fazanëve	Lekë/30 min	50
7	Dhënie me qera për evente artistike e Pyllit të Fazanëve	Lekë/person	100
IV	**Tarifë për sistemin e ujitjes së tokës bujq.**	**Njesia**	**Tarifa**
1	Ujitje me rrjedhje të lirë	Lekë/Ha	3000
2	Ujitje me ngritje mekanike	Lekë/Ha	2000
3	Tarife mirëmbajtje kanale kullues-Fusha e Maliqit	Lekë/dynym	**20**
VI	**Tarifë për kullotat**	**Njësia**	**Tarifa**
1	Dhen	Lekë/krerë/vit	100
2	Dhi	Lekë/krerë/vit	80
3	Gjedhë	Lekë/krerë/vit	800
4	Njëthundrak	Lekë/krerë/vit	800
5	Dhen (në pyll)	Lekë/krerë/vit	50
6	Dhi (në pyll)	Lekë/krerë/vit	100
7	Gjedhë (në pyll)	Lekë/krerë/vit	60
8	Njëthundrak (në pyll)	Lekë/krerë/vit	60
9	Qendër stani e rrethuar	Lekë/m2/vit	50
10	Qendër përpunim bulmeti	Lekë/m2/vit	100
11	Ngrehinë banimi për barinj	Lekë/m2/vit	50
12	Mullinj, magazina	Lekë/m2/vit	100
VII	**Tarifë për drutë e zjarrit**	**Njësia**	**Tarifa**
1	Për banorët vendas	Lekë/5 mst/vit	1800
2	Për të tjerët	Lekë/mst/vit	360
VIII	**Tarifë për mjetet korrëse**	**Njësia**	**Tarifa**
1	Për mjetet brenda Bashkisë Maliq	Lekë/mjet/vit	5 000
2	Për mjetet jashtë Bashkisë Maliq	Lekë/mjet/vit	10 000
IX	Tarifë marje inerte, dhera në territorin e bashkisë	Lekë/m3	100
X	Vendosje e shtyllës matëse (anemometër) për fushatën e matjes së erës.	Lekë/shtyllë/vit	50.000
XI	Dhënie me qira rimorkiator	Lekë/ton/km	12
XII	Dhënie me qira eskavator	Lekë/orë pune	3500

10.TARIFA TË NDRYSHME PËR SHËRBIMET NË BASHKI

Nr	Tarifa	Njësia	Tarifa
I	**Tarifa për shërbimet në Bashki**		
1	Për lëshim vertetimi të thjeshtë	Lekë/copë	50
2	Për lëshim vertetimi të thjeshtë për subjekte fizikë/juridikë	Lekë/copë	100
3	Për vërtetim pensioni	Lekë/copë	500
4	Për nxjerrje dokumenti nga arkivi deri në 15 fletë	Lekë	500
5	Për nxjerrje dokumenti nga arkivi mbi 15 fletë	Lekë	1.000
6	Për vërtetime tenderi ose ankandi ose Formular vlerësimi	Lekë/copë	2.000
7	Për vërtetime për shërbime konsullore jashte Shqipërisë	Lekë/copë	500
8	Për lëshim vërtetimi për formularin 6 për në hipotekë	Lekë/copë	500
9	Për lëshim vërtetimi për sigurimet shoqërore	Lekë/copë	100
10	Për lëshim vërtetimi për ndihmë ekonomike	Lekë/copë	50

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026 www.bashkiamaliq.gov.al